



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1387/1 Prot.

Tiranë, më 09 / 10 / 2018

V E N D I M

Nr. 195, Datë 09 / 10 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.110 Regj., datë 30.07.2018, të znj.R. R, kundër specialistes së pagave pranë Spitalit Rajonal Vlorë (SRV), me pretendimin për diskriminim për shkak “*të gjendjes familjare¹*”, “*gjendjes civile²*” dhe “*gjendjes ekonomike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj.R prej vitit 2012 e në vijim është në marrëdhënie pune me Spitalin Rajonal Vlorë, në pozicionin e punonjësës sociale. Ajo shprehet se prej dy muajsh i është cënuar paga mujore nga ana e specialistes së pagave, znj.E. T. Ankuesja parashtron se, znj.T pa komunikuar paraprakisht me asnjë nga eprorët e saj apo titullarin, i ka cënuar në mënyrë të njëanshme pagën duke i ndryshuar mënyrën e kategorizimit të saj.

Në këto kushte, me shkresën me nr.2570 prot., datë 07.06.2018 ankuesja i është drejtuar shefit të personelit dhe titullarit të institucionit duke kërkuar rishikim të pagës së saj.

Znj.T, në cilësinë e specialistes së pagave i është përgjigjur shkresërisht se ulja e pagës është e mbështetur në ligj. Ndërsa, shefja e personelit e ka sqaruar se: “*Mbështetur në Strukturën analitike të SRV, miratuar nga MSH nr.1181 prot, datë 02.03.2017, ku bëhet një ndarje midis drejtorisë dhe shërbimit spitalor: psikologu dhe punonjësi social futen në shërbimin spitalor, sektori “Psiko-Social”. Sa më sipër, pretendimi i znj.T se ankuesja përfshihet në strukturë në pjesën e drejtorisë dhe për këtë arsye duhet të paguhet si specialiste administrate nuk qëndron*”.

Ankuesja parashtron se natyra e punës së saj nuk është administrative por mjekësore dhe në kontakt të drejtëpërdrejtë me pacientin. Znj.T ka kategorizuar pagën e saj në mënyrë të padrejtë

¹ Si kryefamiljare me një fëmijë të mitur në kujdestari.

² E divorcuar.

dhe në shkelje të parashikimeve ligjore, duke i ulur pagën dhe duke ndikuar në gjendjen ekonomike të familjes së saj, si nënë kryefamiljare, me një fëmijë të mitur në kujdestari; fakt ky i njohur nga ana e znj.T, e cila qëllimisht e ka diskriminuar atë.

Znj.R kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ndalimin e cënimit të pagës së saj, referuar uljes të bërë nga Specialistja e pagave, znj.T.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anekese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale⁴, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- 1. Me shkresën me nr.1066/2 prot., datë 09.08.2018 është njoftuar Spitali Rajonal Vlorë (SRV) dhe i është kërkuar informacion lidhur me pretendimet e ngritura nga punonjësja R. R.**

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁴ Nga pikëpamja formale, ankesa është plotësuar me dokumentacion nga ankuesja me datë 01.08.2018, referuar shkresës me nr.3573 prot., datë 01.08.2018.

Me shkresën nr.3838 prot., datë 13.08.2018 SRV, informon Komisionerin se, drejtuesja e SRV është vënë në dijeni të pretendimeve të punonjësës R.R me anë të shkresës me nr.2570 prot., datë 07.06.2018, përmes së cilës ankohej për ndryshimin (uljen) e pagës së saj nga ana e specialistes së pagave, znj.E. T. Më tej në parashtrimet e veta, znj.B. M, në pozicionin e Drejtores së SRV, thekson se: *“...ky ndryshim është bërë pa dijeninë e shefes së zyrës apo nën/drejtorit ekonomik, si personat përgjegjës për veprimet financiare dhe në kundërshtim të plotë me rregulloren e funksionimit të administratës dhe dispozitave të tjera ligjore në funksionim të administratës publike. Në vijim të sqarimit të kësaj situatë është organizuar një takim me specialisten e pagave, znj.T, juristin, shefen e planit, shefen e burimeve njerëzore pranë SRV-së”*.

Znj.M citon se, paga e punonjësës R ka ardhur me lidhjen e pagave dhe është e vërtetuar nga kjo lidhje që znj.R nuk është pjesë e administratës, dhe ajo nuk duhet paguar si specialiste administrate, siç ka vepruar znj.T, por si pjesë e stafit mjekësor të spitalit. Nga ana tjetër, drejtuesja e spitalit thekson se është bërë përpjekje maksimale nga ana e institucionit për zgjidhjen e kësaj situatë, por sërish edhe pas tërheqjes së vëmendjes për znj.T, ajo ka vijuar dhe në muajt pasardhës të paguajë znj.R si specialiste administrate.

Drejtuesja e SRV thekson faktin se nga ana e tyre është kërkuar audit nga FDSKSH si organi kompetent për zgjidhjen e situatës së kësaj punonjëseje.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 14.09.2018⁵, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të SRV.

Referuar procesverbalit të datës 14.09.2018, mbajtur nga inspektorët e KMD-së, përfaqësuesit e këtij institucioni⁶ shprehen se: *“...znj.T ka kaluar në pozicionin aktual si specialiste pagash me datë 15.05.2018 dhe se më përpara ka qenë në detyrën e specialistes së auditit të brendshëm, po pranë SRV-së. Në pozicionin e mëparshëm, ajo ka audituar dhe pagat e punonjësve, si pjesë e detyrës së saj dhe asnjëherë më përpara nuk e kishte konstatuar si shkelje apo të llogaritur gabim pagën e punonjësës R. Po ashtu, KLSH-ja në raportin e auditit të ushtruar në SRV për vitin 2017, nuk ka konstatuar shkelje në cilësimin e pagës për punonjësën R. Në strukturën e re të SRV pozicioni i punonjësit social, të cilin mban ankuesja, ka kaluar në Shërbimin Spitalor dhe jo më tek Administrata, prandaj znj.R nuk mund të cilësohet apo paguhet si specialiste administrate, por duhet cilësuar dhe paguar si punonjëse e këtij shërbimi”*. Përfaqësueset e SRV sqaruan dhe depozituan në cilësi prove dokumentacion provues, që znj.T një praktikë të ngjashme, lidhur me uljen e pagave ka ndjekur dhe zbatuar edhe për të paktën 5 punonjës të tjerë të SRV, gjë të cilën ato e cilësojnë në tejkallim të kompetencave të saj si specialiste pagash, pasi ajo është nëpunëse zbatuese dhe jo vendimmarrëse. Lidhur me ndryshimin e pagës së punonjësve ajo duhet të marrë miratimin e eprorit direkt të saj.

Specialistja e pagave, znj.T, sa i takon pretendimit për ulje të padrejtë të pagës së punonjësës sociale, znj.R sqaroi se: *“Ndryshimi i pagës për këtë punonjëse është bërë mbështetur në VKM*

⁵ Në zbatim të Urdhërit nr.162, datë 07.09.2018, të Komisionerit.

⁶ Drejtorja e SRV, znj.B M dhe Përgjegjësjja e Burimeve Njerëzore pranë SRV, znj.L N.

nr.188, datë 15.03.2017 “Pagat e punonjësve të shëndetësisë”, lidhja I, Kreu 1.3. Nga verifikimi i listë pagesave për vitin 2016, znj.R është paguar si specialiste me pagë shtesë pozicioni 31050 lekë, pagesë e cila ka vazhduar deri në muajin Tetor 2016. Në muajin Nëntor ka pësuar ndryshim page me rritje duke kaluar te klasa 19 e lidhjes I, Kreu 1.3, pra me pagë shtesë pozicioni 38200 lekë. Ky ndryshim është bërë pa asnjë urdhër të brendshëm, pa kërkesë nga punonjësi dhe nuk rezulton të ketë ardhur si pasojë e ndonjë ndryshimi ligjor për këtë periudhë. Në muajin Maj 2018 me marrjen e detyrës si specialiste e pagave bëra dhe përshtatjet e pagave sipas strukturës aktuale dhe VKM në fuqi. Aktualisht, sipas bazës ligjore në fuqi, paga e një punonjësi social është: shtesë për vështirësi 2%, shtesë për pozicion 34200 lekë, paga bazë 14000 lekë”.

Lidhur me pretendimin se përse paga e punonjësës sociale nuk është konstatuar si shkelje nga ana e znj.T në periudhën kur ajo mbante pozicionin e specialistes së auditit të brendshëm të SRV-së, ajo shprehet se në periudhën e audituar prej saj (së bashku me F.M dhe A.M në komisionin e auditimit) Janar-Qershor 2016, znj.R është paguar si specialiste në përputhje të plotë me ligjin dhe prandaj nuk është cilësuar si shkelje.

Znj.T ka depozituar materiale shtesë lidhur me praktikat e ndjekura prej saj edhe për punonjës të tjerë të SRV-së për të cilët ajo mendon se ka parregullsi në klasifikimin e pagës së tyre, duke cituar se në çdo rast ka zbatuar vetëm ligjin dhe nuk ka patur asnjë lloj diskriminimi për asnjë punonjës të SRV-së, për asnjë shkak.

Znj.T i është drejtuar shkresërisht Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Kontrollit të lartë të Shtetit, lidhur me kërkesën e saj për sqarimin e problematikës së interpretimit ligjor të pagave të disa prej punonjësve të RSV, për të cilët ajo ka konstatuar shkelje; ndër të cilët ka specifikuar konkretisht dhe rastin e punonjësës sociale, znj.R.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm të ankueses nga Specialistja e pagave pranë SRV.

Nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, znj.R prej vitit 2012 e në vijim është në marrëdhënie pune me Spitalin Rajonal Vlorë, në pozicionin e punonjësës sociale. Nga verifikimi që iu bë dokumentacionit të dosjes personale të ankueses, konstatohen paqartësi sa i takon dokumentimit të ndryshimit të pagës së saj.

Nga verifikimi i listë pagesave për vitin 2016, znj.R është paguar si specialiste me pagë shtesë pozicioni 31050 lekë, pagesë e cila ka vazhduar deri në muajin Tetor 2016. Në muajin Nëntor ka pësuar ndryshim page me rritje duke kaluar te klasa 19 e lidhjes I, Kreu 1.3, pra me pagë shtesë pozicioni 38200 lekë. Ky ndryshim është bërë pa asnjë urdhër të brendshëm, pa kërkesë nga punonjësi. Lidhur me situatën e krijuar sa i takon interpretimit ligjor të klasifikimit të pagës së punonjësit social pranë SRV, Komisioneri vlerëson se është detyrim ligjor i institucionit të marrë

masat e nevojshme për zgjidhjen e kësaj problematike, jo vetëm me ankuesen por dhe të gjithë punonjësit e tjerë të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të.

Lidhur me sa më sipër, për efekt krahasimi, Komisioneri ka shqyrtuar dhe praktikën e ndjekura nga ana e specialistes së pagave dhe për punonjës të tjerë, paga e të cilëve ka pësuar ndryshime prej saj. Nga 540 punonjës të punësuar pranë SRV janë bërë ndryshime: për emërtesën, për pozicionin, për vjetërsinë, për vështirësinë në punë, për pagesat e turneve, për pagesat e thirrjeve të mjekëve, rojet e mjekëve, punonjësit mbështetës, për klasat, kategoritë etj. Pra, nga sa shihet nuk është bërë vetëm ulje page për punonjësen sociale, (ankuesen) dhe konkretisht citojmë disa nga ndërhyrjet në pagat e punonjësve:

- L.H i është ulur paga për shkak se në emërtesë është recepcioniste dhe ndërkaq paguhej si specialiste e lartë.
- R.R i është ulur paga pasi në emërtesë është punonjëse sociale dhe paguhej si punonjëse e Psikiatrisë.
- D.L i është ulur paga për shkak se në emërtesë është kuzhinier dhe ndërkaq paguhej si kryekuzhinier.
- E.Ll i është ulur paga duke u përshtatur me emërtesën në strukturë.
- S.B i është ulur paga duke u përshtatur me emërtesën në strukturë.
- L.G i është ulur paga duke u përshtatur me emërtesën në strukturë.
- J.C i është ulur paga pasi në emërtesë është infermier onkologjik dhe ndërkaq paguhej si punonjës i QSUT-së.
- L.Xh për të njëjtën arsye si J.C i është ulur paga.
- V.H i është ulur paga pasi për emërtesën që ka nuk i takon rritje pozicioni.

Nga lista e punonjësve që iu ka ndryshuar paga, konstatohen edhe punonjës të cilëve iu është rritur paga, për shkak se iu është rritur vështirësia, apo iu ka ndryshuar emërtesa në strukturën aktuale, si psh: N.Z, O.A, A.Ll, M.H, I.T, A.A.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet e kryera nga specialistja e pagave të SRV, znj.E. T, për ndryshimet (uljen) në pagën e punonjësës R. R, janë veprime që janë ndërmarrë edhe për punonjës të tjerë të SRV, (cituat rast pas rasti më sipër) dhe ankuesja nuk është vënë në pozita të pabarabarta krahasuar me punonjësit e tjerë. Në këto kushte nuk ka as trajtim të disfavorshëm të ankueses nga znj.T

Neni 7 i LMD-së⁷, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

⁷Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga ana e specialistes së pagave ndaj të cilës është ankuar punonjësja sociale pranë SRV-së, që ekspozon atë ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe jo të barabartë, në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me punonjësit e tjerë.

Ndërsa, sa i takon ligjshmërisë apo jo të veprimeve të ndërmarra prej saj si specialiste e pagave në ndryshimet e bëra në pagat e punonjësve, Komisioneri vlerëson se lidhur me këtë fakt duhet të shprehen organet kompetente, duke qenë se SRV i është drejtuar shkresërisht Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Kontrollit të lartë të Shtetit, lidhur me sqarimin e problematikës së interpretimit ligjor të pagave të disa prej punonjësve të RSV, për të cilët specialistja e pagave ka bërë ndryshimet përkatëse.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj.R. R nga ana e specialistes së SRV, për shkaqet e pretenduara prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(shkaku: gjendja familjare, gjendja civile, gjendja ekonomike)

(fusha: punësim)